



Breaking News:

Shkodër/Kreu parakalim të gabuar në urën e Spatharit, ndëshkohet drejtuesi i automjetit

|| <<>>



12/06/2025

DVP Tiranë/Iu Gjet Armë Zjarri Pistoletë Në Automjetin Që Drejtonte, Arrestohet 28-Vjeçari

DVP Tiranë

Iu gjet armë zjarri pistoletë në automjetin që drejtonte, kapet dhe vihet në pranga nga shërbimet e Forcës së Posaçme “Shqiponja”, 28-vjeçari.

Procedohet penalisht pasagjeri i automjetit, për moskallëzim krimi.

Shpallen në kërkim 2 shtetas (pronari i automjetit dhe përdoruesi aktual i tij).

Sekuestrohen arma e zjarrit pistoletë dhe një sasi municioni luftarak.

Si rezultat i kontrolleve të befasishme të kryera nga shërbimet e Forcës së Posaçme “Shqiponja”, në automjete të ndryshme, është goditur një rast i armëmbajtjes pa leje. Në fshatin Domje, gjatë kontrollit në automjetin me drejtues shtetasin F. M. dhe pasagjer një shtetas 16 vjeç, shërbimet e Policisë gjetën 1 armë zjarri pistoletë dhe një sasi fishekësh.

Në vijim të veprimeve për këtë rast, specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Vorë: -arrestuan shtetasin F. M., 28 vjeç, banues në Domje, për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”; -referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi në gjendje të lirë për 16-vjeçarin, për veprën penale “Moskallëzimi i krimit”; -u shpallën në kërkim shtetasit R. T., 24 vjeç, banues në Domje, pronari i automjetit, dhe V. B., 24 vjeç, banues në Domje, përdoruesi aktual i automjetit, pasi dyshohet se i ka dhënë automjetin 28-vjeçarit.

Vijon puna për kapjen e shtetasve në kërkim dhe për dokumentimin e rastit.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play



Download on the
App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ Klos/Zbardhet ngjarja e ndodhur mbrëmjen e djeshme

DVP Shkodër/Vijon operacioni i koduar “Koordinata”, gjenden 19 739 fidanë dhe bimë kanabisi ▶